



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.434-2/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti, Kryesues, Violeta Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me kërkesën për rishqyrtim Anr.434-2/2025, të parashtruar nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it Anr.434/2025, i datës 10.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 14.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar kërkesa Anr.434-2/2025 e datës 11.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë,

II. Ndryshohet vendimit i PZAP-it Anr.434/2025, i datës 10.02.2025, ashtu që Refuzohet e pa bazuar ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) e parashtruar kundër Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Paneli me Vendimin Anr.434/2025, të datës 10.02.2025, e kishte miratuar ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të parashtruar kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me të cilin vendim i kishte shqiptuar dënim më gjobë në lartësi prej 1.000.00 (njëmijë) Euro, dhe ka detyruar Subjektin Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

PZAP-i, me datë 11.02.2025, ka pranuar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Anr.434/4/2025, nga Subjekti Politik LDK, me të cilën pretendohet se në rastin A.nr. 434/2025, znj. Serbeze Kabashi Muqaj, ka bashkëngjitur provën-pëlqimin lëshuar nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit sa i përket shfrytëzimi të hapësirës së kulturës "Adem Jashari" në të cilën gjendet edhe Muzeu Komunal i Qytetit.

Më tutje parashtruesi i kërkesës ka theksuar se kjo është një provë konkrete, fakt që duhet të ndikojë në vendimin e PZAP-it si aprovim i pjersëritshëm ose i plotë i kërkesës.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se kërkesa për rishqyrtim dhe anulimin e vendimit Anr.434/4/2025 i datës 10.02.2025, është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës përkatësisht kërkesa Anr.434-4/2025, e datës; 11.02.2025, për rishqyrtimin e vendimit, rrjedh se Subjekti Politik LDK ka bashkangjitur si provë pëlqimin nr. 12 nr.12/2025 datë 01.02.2025 të lëshuar nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit sa i përket shfrytëzimi të hapësirës së kulturës "Adem Jashari" në të cilën gjendet edhe Muzeu Komunal i Qytetit. Paneli, Pëlqimin e ofruar nga parashtruesi i kërkesës e konsideroi si provë të pranueshme, sepse i njëjti është lëshuar nga Organi Kompetent, në këtë rast Komuna e Istogut.

Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht neni 118 paragrafi 4, përcakton se, *"Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.*

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që kërkesën për rishqyrtim të aprovoj si të bazuar në kuptim të nenit 118 paragrafin 4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.434-2/2025 datë 14.02.2025



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*